



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 165, datë 12.3.2025

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.848,
DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR STANDARDET, KRITERET E PROCEDURAT E AKREDITIMIT
TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM
TË PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT
SHOQËROR, SI DHE TË OFRUESVE TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39, pika 2, e 43, pika 4, të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.848, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, emërtesa “Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhdueshëm” zëvendësohet me “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror (në vijim, ASCK)”.
2. Në pikën 2, të kreut II, pas fjalës “... licencuara ...” shtohen fjalët “... për ushtrim të veprimtarisë në fushën e kujdesit shoqëror ...”.
3. Fjalja e parë, e pikës 3, të kreut III.2, “Procesi i akreditimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror bëhet në shërbimin *on-line*, që ka Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.”.

4. Pika 16, e kreut III.2, “Procesi i akreditimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. ASCK-ja shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi nëpërmjet shërbimit *on-line*, që ofrohet përmes portalit “*e-Albania*”, me dokument me vulë elektronike dhe, nëse ai është i plotë, bën vlerësimin e tij sipas kriterëve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët, materialet pedagogjike) dhe përgatit raportin përkatës. Në rast se kërkesa nuk është e plotë, ASCK-ja cakton një afat për plotësimin e saj dhe, pas paraqitjes së plotë të dokumenteve, e merr atë në shqyrtim. Kur kërkesa nuk plotësohet brenda afatit të përcaktuar, kërkesa kthehet dhe konsiderohet se nuk është paraqitur.”.

5. Pas pikës 4, të kreut VII, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1.Kërkesat, për të cilat nuk kanë përfunduar procedurat administrative deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, trajtohen në përputhje me dispozitat në fuqi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me përorësi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

ALBANA KOÇIU

NR.PROT. 1234/3
DATE 12.3.2025

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT
SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR
AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE
PAJISJEVE MJEKËSORE
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR
INSPEKTORATIT SHTETËROR SHËNDETËSOR
KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Në mungesë dhe me porosi

Herald JONUZAJ

